



Korniza Evropiane e Kualifikimeve:

mbështesim të mësuarit, punën dhe
lëvizshmërinë përtej kufijve

10-vjetori



Evropiane
sociale

Dorëshkrimi i përfunduar në shkurt 2018,
botimi I

As Komisioni Evropian dhe as ndonjë person që vepron në emër të Komisionit nuk janë përgjegjës për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit të mëposhtëm.

Luksemburg: Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian, 2019

© Bashkimi Evropian, 2019

Imazhet e gatshme: © Shutterstock.com

Ripërdorimi autorizohet me kusht që të bëhet i ditur burimi.

Politika e ripërdorimit të dokumenteve të Komisionit Evropian rregullohet nga Vendimi Nr. 2011/833/EU (OJ L 330, 14.12.2011, fq. 39).

Për çdo përdorim ose riprodhim të fotografive ose të materialeve të tjera për të cilat të drejtat e autorit nuk i ka BE-ja, duhet të kërkohet leje direkt nga zotëruesit e të drejtave të autorit.

Print	ISBN 978-92-76-08535-5	doi:10.2767/454430	KE-02-19-458-SQ-C
PDF	ISBN 978-92-76-08537-9	doi:10.2767/278	KE-02-19-458-SQ-N

Korniza Evropiane e Kualifikimeve:

mbështesim të mësuarit, punën dhe lëvizshmërinë përtej kufijve

Përmbajtja

Parathënie	4
Hyrje	5
Çfarë është KEK-u dhe si funksionon ai?	6
Elementet përshkruese që përcaktojnë nivelet në KEK	17
Si mund të përdoret KEK-u dhe kush përfiton nga KEK-u?	20
Çfarë ndikimi ka deri më tani KEK-u?	25
Një vështrim në të ardhmen	28
Akronimet	30

Parathënie



«Në botën tonë moderne, njerëzit kanë nevojë për mundësi për të ndërtuar aftësitë e tyre dhe për t'i vënë ato në përdorim ndërsa lëvizin mes punëve dhe llojeve të ndryshme të punëve, dhe formimit të mëtejshëm. Korniza Evropiane e Kualifikimeve është një gur themeli i bashkëpunimit tonë për t'i bërë aftësitë dhe kualifikimet e personave që të kuptohen dhe njihen më lehtë kur ata lëvizin vendin e tyre ose jashtë tij për të punuar ose studiuar. Falë KEK-ut, punëdhënësit mund të krahasojnë më lehtë kualifikimet e huaja me ato kombëtare, dhe të kuptojnë më mirë profilet e aftësive të kandidatëve. KEK-u i ndihmon njerëzit të vënë në përdorim talentin e tyre, duke sheshuar rrugën drejt të mësuarit të mëtejshëm dhe duke mbështetur një përputhje më të mirë të aftësive në tregun e punës.»

Marianne Thyssen

Komisionere Evropiane për Punësimin, Çështjet Sociale, Aftësitë dhe Lëvizshmërinë e Punës

Hyrje

Në botën tonë moderne, njerëzit kanë nevojë për një set më të lartë dhe më të gjerë aftësish për të punuar, komunikuar, aksesuar informacione, produkte dhe shërbime, dhe për të marrë pjesë në aktivitete sociale dhe civile.

Është themelore të ekzistojë kuptimi dhe vlerësimi i duhur i aftësive dhe kualifikimeve, për të arritur përputhjen më të mirë mes furnizimit me aftësi dhe nevojave të tregut të punës. Kuptimin dhe vlerësimin e aftësive dhe kualifikimeve mund ta mbështesë një kornizë e përbashkët evropiane. Kjo mund të ndihmojë gjithashtu individët që të fitojnë dhe rifreskojnë aftësitë gjatë jetës së tyre ndërsa lëvizin mes llojeve dhe niveleve të ndryshme të arsimit, mes arsimit dhe punësimit, brenda dhe jashtë vendit.

Kualifikimet shprehin atë që njerëzit dinë, kuptojnë dhe janë në gjendje të bëjnë. Ato mund të marrin formë të ndryshme si p.sh. diplomë (universitare) ose certifikatë (aftësie). Është thelbësore transparenca rreth asaj që personat kanë mësuar faktikisht për të arritur një kualifikim ("rezultatet e të mësuarit") për të garantuar që individët, punëdhënësit dhe ofruesit e arsimit dhe formimit t'u japin kualifikimeve vlerën e duhur ekonomike, sociale dhe akademike.

Korniza Evropiane e Kualifikimeve për të mësuarit gjatë të gjithë jetës (KEK) synon të përmirësojë transparencën, krahasueshmërinë dhe portabilitetin e kualifikimeve të individëve. KEK-u u themelua në vitin 2008 si një kornizë e përbashkët reference e kualifikimeve, të shprehura si rezultate mësimore në rritjen e niveleve të aftësisë. Korniza shërben si mjet konvertues mes sistemeve të ndryshme të kualifikimeve dhe niveleve të tyre. Synimi i saj është të jetë në dobi të studentëve, punonjësve, punëkërkuësve, punëdhënësve, sindikatave, ofruesve të arsimit dhe formimit, organeve të njohjes së kualifikimeve, autoriteteve qeveritare dhe organizatave ndërkombëtare.

Rekomandimi i KEK-ut u rishikua në vitin 2017¹ për ta përshtatur me realitetin e sotëm dhe për të qenë gati për sfidat e ardhshme. Rishikimi i tij ka ruajtur objektivat bazë të rena dakord një dekadë më parë për të krijuar transparencë dhe besim reciprok në tablonë e kualifikimeve në Evropë. Rishikimi ishte një prej 10 veprimeve kyçe të Axfordës së Re të Aftësive për Evropën, që synon të përmirësojë cilësinë dhe përshtatshmërinë e formimit, duke i bërë aftësitë më të dukshme dhe duke përmirësuar inteligjencën². Siç sugjeron emri, KEK-u është gjithashtu një prej kornizave për të ndihmuar aplikimin e parimeve të Shtyllës evropiane të të drejtave sociale³. I pari i 20 parimeve të Shtyllës është që gjithsecili ka të drejtën për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, formim dhe mësim gjatë gjithë jetës, për të ruajtur dhe fituar aftësi që i ndihmojnë ata të marrin pjesë plotësisht në shoqëri dhe të menaxhojnë me sukses tranzicionin në tregun e punës.

1 2018-80078-0-1, me afat përfundimtar 6.12.2018

2 2018-80078-0-1, me afat përfundimtar 6.12.2018

3 2018-80078-0-1, me afat përfundimtar 6.12.2018



Çfarë është KEK-u dhe si funksionon ai?

Çfarë janë kualifikimet?

KEK-u i përkufizon kualifikimet si *“rezultatin zyrtar të një procesi vlerësimi dhe verifikimi që merret kur një organ kompetent përcakton se një individ ka arritur objektivat e të mësuarit sipas standardeve të përcaktuara”*.

Pse janë kualifikimet të rëndësishme?

Kualifikimet shërbejnë për një shumëllojshmëri qëllimesh. Ato u sinjalizojnë punonjësve se çfarë pritet të dinë, të bëjnë dhe të kuptojnë mbajtësit e tyre (“rezultatet e të mësuarit”). Ato mund të nevojiten për të vlerësuar profesione të caktuara. Ato ndihmojnë autoritetet e arsimit dhe formimit të përcaktojnë nivelin dhe përmbajtjen e të mësuarit të fituar nga një individ. Ato janë gjithashtu të rëndësishme për një individ si shprehje e arritjeve personale. Kualifikimet luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen e punësimit, lehtësimin të lëvizshmërisë dhe përmirësimin të aksesit në arsimin e mëtejshëm.

Kualifikimet zakonisht janë në formën e certifikatave dhe diplomave që akordohen pas arsimit, formimit, të mësuarit dhe (ndonjëherë) punës. Përmbajtja dhe niveli i kualifikimeve që janë pjesë e një kornize me siguri cilësie janë burime informacioni të besuara. Ato veprojnë si formë valute që individët mund t'i përdorin për qëllime punësimi ose të mësuarit.

Bërja e kualifikimeve më transparente dhe më të krahasueshme mes vendeve të ndryshme

Sistemet evropiane të arsimit dhe formimit janë diverse dhe reflektojnë traditat kombëtare. Ndryshimet mes tyre e bëjnë të vështirë të vlerësohet se di, kupton dhe është në gjendje të bëjë dikush me një kualifikim nga një vend tjetër në kontekstet e të mësuarit ose të punës. Prandaj, vlera e kualifikimit që jepet në një vend nuk kuptohet detyrimisht në të tjerat, gjë që mund të dëmtojë “besimin” të cilësia dhe përmbajtja e këtyre kualifikimeve. E njëjta gjë ndodh me kualifikimet që jepen jashtë sistemeve zyrtare arsimore dhe formuese, dhe nga institucionet dhe organizatat ndërkombëtare. Kjo mungesë besimi mund të ndikojë në zhvillimin profesional, aksesin në mundësitë e punësimit dhe aksesin në të mësuarit e mëtejshëm, krijimin e barrierave ndaj lëvizshmërisë në BE, brenda dhe mes kufijve.

KEK-u është një kornizë e përbashkët reference që lejon që kualifikimet nga vende të ndryshme të krahasohen me lehtësi. Kjo arrihet duke mbështetur përdorimin e rezultateve të të mësuarit për secilin kualifikim, për t'i bërë ato më transparente dhe më të lehta për t'u kuptuar. Në këtë mënyrë, KEK-u mbështet lëvizshmërinë mes kufijve të studentëve dhe punonjësve, si dhe promovon të mësuarit gjatë të gjithë jetës dhe zhvillimin profesional nëpër Evropë.

Çfarë është korniza e kualifikimeve?

Korniza e kualifikimeve i klasifikon kualifikimet sipas një seti kriteresh për nivele të specifikuar të mësuarit të arritura. Ajo synon të integrojë dhe koordinojë kualifikimet, si edhe të përmirësojë transparencën, aksesueshmërinë dhe cilësinë e kualifikimeve në lidhje me tregun e punës, sistemin e arsimit dhe të formimit, si dhe shoqërinë civile.

Kornizat e kualifikimeve mbështesin të mësuarin gjatë të gjithë jetës (pra, të gjitha aktivitetet e të mësuarit që zhvillohen gjatë jetës), me synimin e përmirësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave brenda një perspektive personale, civile, shoqërore dhe/ose të lidhur me punësimin. Ky përkufizim mbulon gamën e plotë të të mësuarit zyrtar, jozyrtar dhe informal.

KEK: rezultatet e të mësuarit si parim kryesor

Kualifikimet tradicionalisht kanë dhënë informacione rreth kohëzgjatjes së të mësuarit dhe institucionit ose vendndodhjes ku është zhvilluar mësimi. Informacioni rreth asaj që duhet të pritet nga mbajtësi i kualifikimit, në terma të njohurisë, aftësive dhe kompetencave, ka qenë më pak i zakonshëm dhe transparent.

KEK-u, dhe të gjitha Kornizat Kombëtare të Kualifikimeve (KKK-të) që i referohen asaj, ndjekin një përjasje ndaj rezultateve të të mësuarit. Kjo do të thotë se si përmbajtja ashtu edhe niveli i një kualifikimi reflekton atë që pritet që mbajtësit e tij të dinë, të kuptojnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë (rezultatet e të mësuarit).

Zhvendosja drejt rezultateve të të mësuarit rrit transparencën e një kualifikimi dhe përmirëson krahasueshmërinë mes vendeve dhe brenda vendeve (p.sh. mes llojeve të ndryshme të kualifikimeve në të njëjtin nivel, ose niveleve të ndryshme të kualifikimeve të të njëjtit lloj). Përmes fokusimit të rezultatet e të mësuarit, KEK-u mund të ndihmojë qytetarët të orientohen brenda një mjedisi gjithnjë e më divers dhe kompleks të kualifikimeve.

Një përjasje ndaj rezultateve të të mësuarit mbështet më tej një përputhje më të mirë mes nevojave për aftësi të tregut të punës dhe ofrimit të arsimit dhe formimit, duke lehtësuar njëkohësisht verifikimin e të mësuarit të fituar në cilësime të ndryshme. Duke u fokusuar në atë që një student di, mund të bëjë dhe mund të kuptojë, rezultatet e të mësuarit ndihmojnë në hapjen e kualifikimeve për një shumëllojshmëri më të madhe rrugësh dhe përvojash të të mësuarit.

Korniza e përbashkët e referencës së elementeve përshkruese të nivelit është thelbi i KEK-ut

KEK-u përkufizohet nga tetë nivele të mësuarit bazuar në rezultatet. Elementet përshkruese shoqëruese të nivelit tregojnë se si rriten pritshmëritë e njohurive, aftësive, autonomisë dhe përgjegjësisë ndërsa studentët përparojnë nga niveli 1 deri në nivelin 8. Këto nivele, së bashku me elementet përshkruese, funksionojnë si mjet konvertues dhe e bëjnë të mundur që të krahasohen kualifikimet nga vende dhe institucione të ndryshme.

Elementet përshkruese të rezultateve të të mësuarit

Elementet përshkruese të të mësuarit të KEK-ut (shih faqen 17) reflektojnë dy dimensione: nivelet dhe domenet e të mësuarit.

Dimensioni i “nivelet” regjistron se si rritet kompleksiteti i rezultateve të të mësuarit së bashku me nivelet e kualifikimit. Për shembull, niveli i autonomisë së pritshme nga mbajtësi i një kualifikimi të nivelit 2 është shumë më i ulët se pritshmëritë e një mbajtësi të një kualifikimi të nivelit 7.

Dimensioni “domenet e të mësuarit” bëjnë dallim mes “njohurive”, ‘aftësive’ dhe “autonomisë dhe përgjegjësisë”, duke lejuar që lloje të ndryshme kualifikimesh të klasifikohen në të njëjtin nivel. Për shembull, kualifikimet me të njëjtin nivel të përgjithshëm rezultatesh mësimore mund të jenë të një orientimi më akademik apo profesional.

KEK-u është projektuar të mbulojë të gjitha llojet e kualifikimeve duke përfshirë ato nga arsimi i lartë, arsimi dhe formimi profesional (AFP) dhe arsimi i përgjithshëm, si edhe kualifikimet e dhëna nga sektori privat ose organizatat ndërkombëtare.

Kufijtë e KEK-ut

Brenda kontekstit të BE-së, politikat dhe veprimet në lidhje me aftësitë dhe kualifikimet (përveç atyre që japin akses në profesionet e rregulluara) bazohen në Nenet 165 (arsimi) dhe 166 (formimi profesional) të Traktatit mbi Funkcionimin e BE-së. Të dyja nenet e bëjnë të qartë se veprimi i BE-së lidhet me inkurajimin e bashkëpunimit mes Shteteve Anëtare dhe, nëse është e nevojshme, mbështetjen dhe plotësimin e veprimit të tyre, ndërkohë që respekton plotësisht sistemet e tyre të arsimit dhe formimit profesional, si edhe diversitetin kulturor dhe gjuhësor.

Çfarë nuk është KEK-u:

- nuk është një kornizë për të harmonizuar kualifikimet ose standardet e kualifikimeve mes Shteteve Anëtare të BE-së (por mund të sjellë zhvillimin e kualifikimeve të ngjashme mes dy ose më shumë vendeve);
- nuk sjell njohjen automatike të kualifikimeve mes Shteteve Anëtare të BE-së (por mund ta bëjë njohjen më të lehtë përmes transparencës së shtuar që sjell);
- nuk është një kornizë e fokusuar te klasifikimi i kompetencave individuale përmes elementeve përshkruese të bazuara te rezultatet e të mësuarit (por KEK-u mund të frymëzojë dhe lehtësojë vlerësimin dhe verifikimin, për shembull, të aftësive që fitohen përmes punës dhe përvojave të jetës).

Si funksionon në praktikë referencimi i KEK-ut?

Rekomandimi i KEK-ut fton Shtetet Anëtare të referojnë KKK-të ose sistemet e tyre të KEK-u, për të krijuar një marrëdhënie të qartë dhe transparente mes niveleve të kualifikimit kombëtar dhe të niveleve të KEK-ut.

Duke qenë se KEK-u është pikë së pari një mjet konvertues, kualifikimet nuk përfshihen direkt në KEK. Në vend të kësaj, ato përfshihen në KKK, ku niveli dhe vlera e tyre jashtë vendit mund të kuptohet duke iu referuar të niveleve të KEK-ut. Ky konvertim bëhet i dukshëm për qytetarët ndërsa nivelet e KEK-ut shtohen gjithnjë e më shumë në certifikatave dhe diplomave kombëtare dhe përfshihen në KKK.

Secili shtet që dëshiron të krijojë lidhje me kualifikimet kombëtare me KEK-un duhet të përgatisë një raport të detajuar referencimi që ndjek 10 kriteret e referencimit të KEK-ut të rëna dakord në Aneksin III të Rekomandimit të KEK-ut, të ndryshuar.

Kriteret e referencimit duhet të garantojnë që KKK-të t'i referencohen KEK-ut në një mënyrë koherente dhe transparente. Kriteret gjithashtu ndihmojnë me strukturimin e raporteve të referencimit, që duhet të përfshijnë gjithashtu kontribute dhe deklarata me shkrim nga organet kombëtare të sigurisë së cilësisë dhe ekspertë ndërkombëtarë.

Kriteret e referencimit të KEK-ut

1. Përgjegjësitë dhe/ose kompetencat ligjore të të gjitha organeve përkatëse kombëtare në procesin e referencimit përcaktohen dhe publikohen qartë nga autoritetet kompetente.
2. Ekziston një lidhje e qartë dhe e demonstrueshme mes niveleve të kualifikimeve në KKK ose sistemeve dhe elementeve përshkruese të niveleve të KEK-ut.
3. KKK-të ose sistemet dhe kualifikimet e tyre, bazohen në parimin dhe objektivin e rezultateve mësimore, dhe lidhen me përgatitjet për verifikimin e të mësuarit jozyrtar dhe informal dhe, ku është e përshtatshme, sistemet e krediteve.
4. Procedurat për përfshirjen e kualifikimeve në KKK, ose për përshkrimin e vendit të kualifikimeve në sistemin kombëtar të kualifikimeve, janë transparente.
5. Sistemi ose sistemet kombëtare të sigurisë së cilësisë për arsimin dhe formimin u referohen KKK-ve ose sistemeve dhe janë në përputhje me parimet për sigurinë e cilësisë siç specifikohet në Aneksin IV të Rekomandimit të KEK-ut.
6. Procesi i referencimit duhet të përfshijë një deklaram të formuluar nga organet e sigurisë së cilësisë se raporti i referencimit është në përputhje me marrëveshjet, dispozitat dhe praktikën përkatëse kombëtare të sigurisë së cilësisë.
7. Procesi i referencimit duhet të përfshijë ekspertë ndërkombëtarë dhe raportet e referencimit duhet të përmbajnë deklaramet me shkrim nga të paktën dy ekspertë ndërkombëtarë nga dy vende të ndryshme rreth procesit të referencimit.
8. Autoriteti ose autoritetet kompetente duhet të verifikojnë referencimin e KKK-ve ose sistemeve pranë KEK-ut. Një raport gjithëpërfshirës, që përcakton referencimin dhe provat që e mbështesin, duhet të publikohet nga autoritetet kompetente, duke përfshirë Pikat Kombëtare të Koordinimit të KEK-ut dhe duhet t'i adresohet secilit prej kriterëve veçmas. I njëjti raport mund të përdoret për vetë-certifikimin në Kornizën e Kualifikimeve të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë, në përputhje me kriteret e vetë-certifikimit të kësaj të fundit.
9. Brenda gjashtë muajve nga referencimi ose përditësimi i raportit të referencimit, Shtetet Anëtare dhe vendet e tjera pjesëmarrëse duhet të publikojnë raportin e referencimit dhe të japin informacione koherente për qëllime krahasuese në portalin përkatës evropian.
10. Përveç procesit të referencimit, të gjitha dokumentet e lëshuara së fundi në lidhje me kualifikimet që janë pjesë e KKK-së ose sistemeve (p.sh. certifikatat, diplomat, suplementet e certifikatave/diplomave) dhe/ose regjistrat e kualifikimeve të lëshuara nga autoritetet kompetente duhet të përmbajnë një referencë të qartë, përmes KKK-ve ose sistemeve, për nivelin përkatës të KEK-ut.

Roli i Grupit Këshillues të KEK-ut

Grupi Këshillues i KEK-ut është ngritur në vitin 2008 për të siguruar koherencën e përgjithshme dhe për të promovuar transparencën dhe besimin në procesin e referencimit. Roli i tij u konfirmua nga Rekomandimi i vitit 2017.

Grupi drejtohet nga Komisioni Evropian dhe përbëhet nga përfaqësuesit kombëtarë (dy për çdo Shtet Anëtar dhe për secilin prej 11 vendeve të tjera pjesëmarrëse), faktorët e tregut të punës, përfaqësuesit e arsimit dhe formimit dhe të shoqërisë civile, si edhe Këshilli i Evropës. Ai mbështetet nga ekspertiza e Qendrës Evropiane për Zhvillimin e Formimit Profesional (Cedefop) dhe Fondacioni Evropian i Formimit Profesional (ETF).

Grupi e diskuton secilin raport referencimi me detaje dhe jep përshtypjet për vendet prezantuese. Prezantimi dhe diskutimi i raporteve ka synim të përmirësimit të kuptuarit e KKK-ve dhe sistemeve mes vendeve pjesëmarrëse në implementimin e KEK-ut. Qëllimi i këtij procesi është të arrihet në një kuptim realist të KKK-ve dhe lidhjes së tyre me KEK-un, si edhe kualifikimeve të përfshira në KKK dhe të mekanizmave të sigurisë së cilësisë. Në këtë proces vlerësimi, anëtarët e KEK-ut luajnë rolin e “miqve kritikë” dhe ndihmojnë kolegët nga vendet e tjera të paraqesin sistemet dhe kualifikimet e tyre në një mënyrë transparente.

Një vend referohet te KEK-u sapo Grupi Këshillues i KEK-ut ta konsiderojë raportin e referencimit si mjaft transparent dhe në respektim me të 10 kriteret referencuese të KEK-ut. Nëse Grupi Këshillues nuk e gjen të kënaqshëm raportin dhe shpjegimet e dhëna, vendit do t'i kërkohet të japë qartësime ose të paraqesë një raport të rishikuar gjatë një takimi tjetër të Grupit Këshillues të KEK-ut.

Si forumi qendror për bisedime mes Komisionit, Shteteve Anëtare dhe grupeve të interesit në implementimin e KEK-ut, Grupi Këshillues i KEK-ut luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin e besimit mes vendeve të përfshira në KEK. Besimi zhvillohet më tej përmes aktiviteteve të të mësuarit në grup me një fokus tematik specifik.

Rishikimi i Rekomandimit të KEK-ut në maj 2017

Krijimi i KEK-ut nisi procesin e lehtësimit të krahasimit të kualifikimeve në Evropë. Në vitin 2017, Rekomandimi i KEK-ut, që reflektonte mbështetje të fortë nga të gjitha Shtetet Anëtare, u rishikua për të përfshirë të gjithë elementet që do të ndihmojnë që korniza t'u përshtatet sfidave të sotme dhe të ardhshme. Përfshihen këto elemente të reja:

- një ftesë për Shtetet Anëtare për të mbajtur të përditësuara referimet e KKK-ve për KEK-un;
- parime të rishikuara të sigurisë së cilësisë të fokusuar te kualifikimet;
- shkëmbime informacioni dhe konsultime mes Shteteve Anëtare për të garantuar konsistencë në nivelet e caktuara për kualifikimet ndërkombëtare të përfshira në KKK-të e tyre;
- mundësinë e zhvillimit dhe aplikimit të kriterëve dhe procedurave për të mundësuar krahasimin e kornizave të kualifikimeve të vendeve të treta me KEK-un;
- rekomandime në lidhje me komunikimin e përmirësuar rreth KEK-ut.

Gjithashtu, praktikat ekzistuese u bënë më transparente nga përfshirja e tyre në rekomandim (p.sh. kriteret e referencimit të KEK-ut).

Përditësimi i referencimit të KEK-ut

Raportet e referencimit të KEK-ut reflektojnë një tablo të çastit dhe me kalimin e kohës bëhen të papërdorshme me zhvillimin e KKK-ve dhe sistemeve. Kjo është arsyeja pse Rekomandimi i rishikuar i KEK-ut fton Shtetet Anëtare të rishikojnë dhe përditësojnë raportin e tyre të referencimit kur është e përshtatshme. Informacioni i përfshirë në raportet e referencimit duhet të jetë i saktë dhe transparent, sepse kjo ndikon direkt në nivelin sa besohet KEK-u. Në këtë mënyrë, konvertimi i niveleve kombëtare të kualifikimeve në nivelet e KEK-ut do të mbetet koherent dhe në përputhje me sistemet kombëtare të kualifikimeve. Kjo gjithashtu përcakton se deri në çfarë niveli është në gjendje KEK-u të lehtësojë krahasueshmërinë dhe mbartshmërinë e kualifikimeve.

Referencimi i KKK-ve të KEK-u, dhe krahasueshmëria e disponueshme përmes kësaj, ndikon gjithashtu në rishikimin dhe rinovimin e kualifikimeve kombëtare. Procesi i të mësuarit në grup që zhvillohet në nivel BE-je mund të tregojë ndryshimet në sistemin e arsimit, formimit dhe kualifikimeve që mund t'u sjellin përfitime studentëve.

Publikimi i raporteve të referencimit

Vendet e referuara te KEK-u ftohen që t'i bëjnë rezultatet e procesit të disponueshme publikisht brenda gjashtë muajve, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel evropian. Në nivel evropian, kjo bëhet aktualisht përmes PLOTEUS.

Vendet mund ta ndajnë gjithashtu informacionin në databazat ose regjistrat kombëtarë të kualifikimeve duke i lidhur ato me PLOTEUS ose të publikojnë kualifikimet e tyre në portalin ESCO. Të dhënat mbi kualifikimet duhet të përfshijnë nivelin sipas KEK-ut (dhe KKK-së) si dhe informacion rreth rezultateve mësimore. Informacioni i publikuar i bën kualifikimet menjëherë të aksesueshme për individët, punëdhënësit, ofruesit e arsimit dhe formimit, organet e njohjes së kualifikimeve etj.

Nivelet e KEK-ut në certifikata, suplemente dhe në regjistrat e kualifikimeve

Pasi referohen te KEK-u, vendet ftohen të shtojnë një referencë të qartë te niveli i duhur i KEK-ut për dokumentet e kualifikimit të lëshuara nga autoritetet kompetente (p.sh. certifikatat, diplomat, suplementet) dhe/ose regjistrat e kualifikimeve. Paraqitja në certifikata dhe diploma ndihmon që KEK-u (dhe KKK-ja) të jetë e dukshme për individët dhe punëdhënësit.

Parimet e sigurisë së cilësisë së KEK-ut

Besimi në cilësinë dhe nivelin e kualifikimeve me një nivel KEK-u është thelbësor për të mbështetur lëvizshmërinë përmes kufijve sektorialë dhe gjeografikë, duke e bërë të rëndësishme sigurinë e cilësisë. Rekomandimi i vitit 2017 ka përforcuar parimet e sigurisë së cilësisë së KEK-ut, të cilat shprehen në mënyrat e mëposhtme:

- Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që kualifikimet me një nivel KEK-u të jenë në përputhje me parimet e zakonshme për sigurinë e cilësisë të përcaktuara në Aneksin IV, pa paragjykuar parimet kombëtare të sigurisë së cilësisë që aplikohen për kualifikimet kombëtare.
- Kriteret 5 dhe 6 të referencimit të KEK-ut lidhen me sigurinë e cilësisë. Kriteri 5 kërkon që sistemi ose sistemet kombëtare të sigurisë së cilësisë për arsimin dhe formimin t'u referohen KKK-ve ose sistemeve dhe janë në përputhje me parimet për sigurinë e cilësisë siç specifikohet në Aneksin IV të Rekomandimit. Kriteri 6 shprehet se procesi i referencimit duhet të përfshijë një deklaram të formuluar nga organet e sigurisë së cilësisë se raporti i referencimit është në përputhje me marrëveshjet, dispozitat dhe praktikën përkatëse kombëtare të sigurisë së cilësisë.
- Aneksi IV i Rekomandimit të KEK-ut përmban 10 parime të sigurisë së cilësisë për kualifikimet që janë pjesë e KKK-ve ose sistemeve të referuara në KEK. Ato shprehen se të gjitha kualifikimet me një nivel KEK-u duhet të kenë siguri cilësie për të përmirësuar besimin në cilësinë dhe nivelin e tyre. Parimet janë të pajtueshme me dy korniza ekzistuese evropiane për sigurinë e cilësisë: korniza e Standardeve dhe Direktivave Evropiane (SDE) për arsimin e lartë dhe korniza e Sigurisë Evropiane të Cilësisë në Arsimin dhe Formimin Profesional (SECAFP) për AFP.

Parimet e sigurisë së cilësisë për kualifikimet me një nivel KEK-u

Sipas rrethanave kombëtare, dhe duke marrë në konsideratë ndryshimet sektoriale, siguria e cilësisë së kualifikimeve me një nivel KEK-u duhet:

- t'i adresohet hartimit të kualifikimeve si edhe aplikimit të përjasjes së rezultateve mësimore;
 - të sigurojë verifikimin e vlefshëm dhe të besueshëm sipas standardeve transparente dhe të rëna dakord të bazuara te rezultatet mësimore, dhe t'i adresohet procesit të certifikimit;
 - të konsistojë në mekanizma dhe procedura për përshtypjet për përmirësim të vazhdueshëm;
 - të përfshijë të gjitha grupet përkatëse të interesit në të gjitha fazat e procesit;
 - të përbëhet nga metoda konsistente vlerësimi, vetëvlerësime dhe rishikime të jashtme;
 - të jetë pjesë përbërëse e menaxhimit të brendshëm, duke përfshirë aktivitetet e nënkontraktuara, e organeve që lëshojnë kualifikimet në nivel KEK-u;
 - të bazohet në objektiva, standarde dhe direktiva të qarta dhe të matshme;
 - të mbështetet nga burime të përshtatshme;
 - të përfshijë një rishikim të rregullt të organeve ose agjencive monitoruese të jashtme ekzistuese që kryejnë sigurinë e cilësisë;
 - të përfshijë rezultate vlerësimi që mund të vlerësohen elektronikisht.
-

KEK-u dhe sistemet e krediteve

Duke përdorur përfaqshen e rezultateve mësimore, KEK-u dhe KKK-të duhet të mbështesin më mirë individët kur ata lëvizin (i) mes niveleve të ndryshme të arsimit dhe formimit, (ii) brenda dhe mes sektorëve të arsimit dhe formimit, (iii) mes arsimit dhe formimit dhe tregut të punës, si dhe (iv) brenda dhe përtej kufijve.

Sipas Rekomandimit të rishikuar, Shtetet Anëtare të BE-së bien dakord se nëse KKK-të përmbajnë ose janë të lidhura me sisteme krediti, këto duhet të mbarten në mënyrë të koordinuar për të mbështetur tranzicionet dhe për të lehtësuar përparimin. Prandaj, janë zhvilluar shtatë parime që janë të përputhshme me mjetet ekzistuese të transparencës për sistemet e krediteve si Sistemi Evropian i Transferimit dhe i Grumbullimit të Krediteve (SETGK) në arsimin e lartë dhe Sistemi Evropian i Krediteve për Arsimin dhe Formimin Profesional (SEKAFP) në AFP.

KEK-u dhe Korniza e Kualifikimeve të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë

KEK-u është i krahasueshëm me Kornizën e Kualifikimeve për Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe elementeve përshkruese të ciklit të saj. Korniza është dakordësuar nga ministrat e arsimit të Procesit ndërqeveritar të Bolonjës në vitin 2005. Me përjashtim të Kosovës⁴, të gjitha vendet e KEK-ut marrin pjesë në procesin e Bolonjës. Cikli i shkurtër (që mund të lidhet me ciklin e parë ose brenda tij), cikli i parë, i dytë dhe i tretë i kornizës u korrespondojnë përkatësisht niveleve 4-8 të KEK-ut.

Shumica e vendeve që i janë referuar KEK-ut kanë përgatitur një raport unik që përfshin gjithashtu vetë-certifikimin e Kornizës së Kualifikimeve të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë.

4 Ky përcaktim bëhet pa paragjykuar pozicionin për statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi deklarinin e pavarësisë nga Kosova.

Elementet përshkruese që përcaktojnë nivelet në KEK



Njohuritë

Në kontekstin e KEK-ut, njohuritë përshkruhen si teorike dhe/ose faktike.



Aftësitë

Në kontekstin e KEK-ut, aftësitë janë të përshkruara si kognitive (përfshijnë përdorimin e të menduarit logjik, intuitiv dhe kreativ) ose praktike (përfshin shkathtësitë manuale dhe përdorimin e metodave, materialeve, veglave dhe instrumenteve).

Niveli 1	Njohuri të përgjithshme bazë.	Aftësi bazë që kërkohen për të kryer detyra të thjeshta.
Niveli 2	Njohuri faktuale bazë të një fushe pune ose studimi.	Aftësi bazë konjitive dhe praktike të kërkuara për të përdorur informacione për të kryer detyra dhe për të zgjidhur probleme rutinë duke përdorur rregulla dhe mjete të thjeshta.
Niveli 3	Njohuri të fakteve, parimeve, proceseve dhe koncepteve të përgjithshme në një fushë pune ose studimi.	Një gamë aftësish konjitive dhe praktike të kërkuara për të përbushur detyra dhe për të zgjidhur probleme duke zgjedhur dhe aplikuar metoda, mjete, materiale dhe informacione bazë.
Niveli 4	Njohuri faktuale dhe teorike në kontekste më të gjera brenda një fushe pune ose studimi.	Një gamë aftësish konjitive dhe praktike të kërkuara për të gjeneruar zgjidhje për probleme specifike në një fushë pune ose studimi.
Niveli 5	Njohuri gjithëpërfshirëse, të specializuara, faktuale dhe teorike brenda një fushe pune ose studimi, si dhe një ndërgjegjësimit për kufijtë e asaj njohurie.	Një gamë gjithëpërfshirëse e aftësive konjitive dhe praktike që nevojiten për të zhvilluar zgjidhje krijuese ndaj problemeve abstrakte.
Niveli 6	Njohuri të përparuara të një fushe pune ose studimi, duke përfshirë kuptimin kritik të teorive dhe parimeve.	Aftësi të përparuara, që demonstrojnë kompetencë të lartë dhe inovacion, të kërkuara për të zgjidhur probleme komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar pune ose studimi.
Niveli 7	Njohuri tepër të specializuara, disa prej të cilave janë në pararojë të njohurive, në një fushë pune ose studimi, si bazë e mendimit dhe/ose kërkimeve origjinale. Ndërgjegjësimit kritik rreth problemeve të njohurive në një fushë dhe në ndërfaqen mes fushave të ndryshme.	Aftësi të specializuara për zgjidhjen e problemeve që kërkohen në kërkime dhe/ose inovacione për të zhvilluar njohuri dhe procedura të reja, si dhe për të integruar njohuri nga fushat e ndryshme.
Niveli 8	Njohuri në nivelin më të përparuar të një fushe pune ose studimi, dhe në ndërfaqen mes fushave.	Aftësitë dhe teknikat më të përparuara dhe të specializuara, duke përfshirë sintezën dhe vlerësimin, që kërkohen për të zgjidhur probleme kritike në kërkim dhe/ose inovacion, si dhe për të zgjeruar dhe ridefinuar njohuritë ose praktikën profesionale ekzistuese.



Përgjegjësia dhe autonomia

Në kontekstin e KEK-ut, përgjegjësia dhe autonomia përshkruhen si aftësia e studentit për të aplikuar njohuritë dhe aftësitë në mënyrë autonome dhe me përgjegjësi.

Puna ose studimi nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë në kontekst të strukturuar.	Niveli 1
Puna ose studimi nën mbikëqyrje me njëfarë autonomie.	Niveli 2
Marrja e përgjegjësive për pëmbushjen e detyrave në punë ose studim. Përshtatja e sjelljes me rrethanat në zgjidhjen e problemeve.	Niveli 3
Ushtrimi i vetë-menaxhimit brenda direktivave të konteksteve të punës ose studimit që janë zakonisht të parashikueshme, por janë subjekt i ndryshimeve. Mbikëqyrja e punës rutinë të të tjerëve, marrja e disa përgjegjësive për vlerësimin dhe përmirësimin e aktiviteteve të punës ose studimit.	Niveli 4
Ushtrimi i menaxhimit dhe mbikëqyrjes në kontekstet e aktiviteteve të punës ose studimit ku ka ndryshime të paparashikueshme. Rishikimi dhe zhvillimi i performancës së vetes dhe të të tjerëve.	Niveli 5
Menaxhimi i aktiviteteve komplekse teknike ose profesionale, marrja e përgjegjësive për vendimarrje në kontekste të paparashikueshme të punës ose studimit. Marrja e përgjegjësive për menaxhimin e zhvillimit profesional të individëve dhe grupeve.	Niveli 6
Menaxhimi dhe transformimi i konteksteve të punës ose studimit që janë komplekse, të paparashikueshme dhe që kërkojnë përjasje të reja strategjike. Marrja e përgjegjësive për kontribimin në njohuritë dhe praktikën profesionale dhe/ose për rishikimin e performancës strategjike të ekipeve.	Niveli 7
Demonstrimi në shkallë të konsiderueshme i autoritetit, inovacionit, autonomisë, integritetit shkencor dhe profesional dhe angazhimi i qëndrueshëm ndaj zhvillimit të ideve ose proceseve të reja në pararojë të konteksteve të punës ose studimit, duke përfshirë kërkimet.	Niveli 8



**Si mund të përdoret KEK-u
dhe kush përfiton nga KEK-u?**

KEK-u është krijuar për një numër qëllimesh. Ndërkohë që qëllimi i tij kryesor është të ndihmojë qytetarët individualë të ndjekin karrierën e tyre në mësim dhe në punë, korniza mbështet gjithashtu te grupet e interesit në arsim, formim dhe punësim për të përmirësuar politikatat dhe praktikatat. Një kornizë referencë gjithëpërfshirëse dhe përfshirëse për kualifikimet, duke iu adresuar të gjitha llojeve dhe niveleve, KEK-u ka shumë përdorues, që variojnë nga individët, punëdhënësit, sindikatat, ofruesit e arsimit dhe formimit, organet e njohjes së kualifikimeve deri te autoritetet qeveritare dhe organizatat ndërkombëtare.

Disa avantazhe të vërtetuara dhe të pritshme për audiencat e ndryshme përmbledhen më poshtë.

KEK-u mbështet karrierën në tregun e punës

Kualifikimet ofrojnë akses në tregun e punës dhe ofrojnë bazën mbi të cilën ndërtohet karriera. Gjetja e një pune ose ndërrimi i punëve, kërkon kualifikime që duhen kuptuar, gjykuar drejt dhe vlerësuar saktë nga punëdhënësit dhe grupet e tjera të interesit të tregut të punës. Prandaj është e rëndësishme aftësia që një kualifikim të sinjalizojë se çfarë di, kupton dhe është në gjendje të bëjë mbajtësi i tij.

Përdorimi i rezultateve të të mësuarit për të përshkruar kualifikimet - dhe përfshirja e niveleve të kualifikimeve evropiane dhe kombëtare në to - e bën më të lehtë që punëdhënësit të interpretojnë kualifikimet e aplikantëve.

KEK-u u jep mundësinë gjithashtu punëdhënësve të vlerësojnë më mirë kualifikimet nga vendet e tjera dhe institucionet që nuk janë të njohura prej tyre. Ato ndihmojnë që të kuptohet më mirë niveli i secilit kandidat, të krahasohen kualifikimet e tyre me kualifikimet kombëtare, të kuptohet rëndësia e atyre kualifikimeve dhe të shikohet se si rezultatet e të mësuarit përputhen me nevojat e kompanisë ose të sektorit.

Përmes KEK-ut, punëdhënësit mund ta trajtojnë Evropën si një zonë të vetme kualifikimesh. Kjo redukton barrierat ndaj lëvizshmërisë së punës, mbështet një përdorim më të mirë të njohurive ekzistuese, si dhe përmirëson përputhjen mes kërkesës dhe ofertës për punë.

KEK-u promovon një gjuhë të përbashkët mes arsimit dhe formimit dhe tregut të punës

Duke promovuar zhvendosjen te rezultatet e të mësuarit, KEK-u mund të lehtësojë gjithashtu dialogun rreth nevojave të tregut të punës dhe dispozitat e sistemeve të arsimit dhe formimit. Dialogu i strukturuar duke përdorur rezultatet e të mësuarit si gjuhë e përbashkët, ndihmon që të forcohet përshtatshmëria dhe të rritet aftësia tërheqëse e kualifikimeve.

KEK-u dhe KKK-të si hartë që ndihmojnë studentët të marrin vendime rreth arsimit dhe formimit të mëtejshëm

KEK-u, duke qenë i lidhur ngushtë me KKK-të në 39 vende evropiane⁵, ofron një hartë gjithëpërfshirëse të të gjitha llojeve dhe niveleve të kualifikimeve në Evropë. Për të identifikuar nivelin e një kualifikimi të caktuar dhe se si lidhet ai me kualifikimet e tjera, studentët mund të përdorin kornizat që janë gjithnjë e më të aksesueshme përmes databazave kombëtare të kualifikimeve. Si një hartë që lidh bashkë KKK-të e ndryshme, KEK-u është i rëndësishëm për grupe të ndryshme nxënësish dhe ofron një përmbledhje lehtësisht të aksesueshme të kualifikimeve dhe rrugëve drejt kualifikimeve. Individët që kërkojnë arsim ose trajnim të mëtejshëm mund të përdorin kornizat si një pikë hyrjeje në informacione rreth kurseve dhe programeve të përshtatshme.

KEK-u dhe KKK-të shërbejnë si një instruktor i të mësuarit gjatë gjithë jetës

Hapja e kualifikimeve ndaj një shumëllojshmërie më të gjerë të përvojave të të mësuarit, për shembull nga puna dhe koha e lirë, është thelbësore për promovimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Përqasja e rezultateve të të mësuarit bën të mundur që të merren në konsideratë përvojat nga jashtë edukimit zyrtar.

Verifikimi i të mësuarit jozyrtar dhe informal në Evropë

Shumica e vendeve evropiane tani kanë në zbatim marrëveshje për verifikimin e të mësuarit jozyrtar dhe informal. Këto marrëveshje bëjnë të mundur që studentëve mësimi i tyre parësor t'u identifikohet, vlerësohet dhe, nëse plotëson kërkesat dhe standardet e kërkuara, të njihet si kualifikim i pjesshëm apo i plotë. Kjo është e rëndësishme për qytetarët sepse shmanget puna e dyfishtë dhe merren në konsideratë përvojat diverse dhe të pasura të të mësuarit⁶.

Rrugët fleksibël të të mësuarit janë parakushte të rëndësishme për të lehtësuar të mësuarit gjatë gjithë jetës. Marrëveshjet e transferimit dhe grumbullimit të krediteve përbëjnë pjesë të kësaj përqasjeje. KEK-u dhe përqasja e tij ndaj rezultateve të të mësuarit mbështet transferimin dhe grumbullimin e krediteve dhe, së bashku me verifikimin e të mësuarit jozyrtar dhe informal, mund të lehtësojnë direkt të mësuarit gjatë gjithë jetës.

5 2018-80078-0-1, me afat përfundimtar 6.12.2018

6 2018-80078-0-1, me afat përfundimtar 6.12.2018

Kualifikimet me një nivel KEK-u janë një valutë e besuar

Duke qenë se sistemet e arsimit dhe formimit ndryshojnë mes vendeve, mund të jetë e vështirë të vlerësohet vlera dhe përshtatshmëria e kualifikimeve të huaja. Si rezultat, ekziston rreziku që kualifikimet të mos gjykohen dhe vlerësohen drejt. I njëjti problem mund të lindë kur kombinohen kualifikime nga sektorë dhe institucione të ndryshme arsimore dhe formuese.

Nivelet e KEK-ut tani përfshihen gjithnjë e më shumë në certifikatat dhe diplomat kombëtare në mbarë Evropën, duke e bërë të mundur që të shihet se si një kualifikim i caktuar lidhet me të tjerë në një kontekst më të gjerë evropian. Bashkëpunimi sistematik dhe afatgjatë mes vendeve përmes KEK-ut dhe KKK-ve, që veprojnë si mbrojtës të kualifikimeve të cilësisë së siguruar, garanton që këto nivele të jenë të besuara në mbarë Evropën. Si rezultat, qytetarët mund të dallojnë më lehtë mes kualifikimeve që mund të besohen dhe atyre që nuk mund të besohen, ose që janë “të rreme”. Në këtë mënyrë KEK-u shërben gjithashtu si një lloj “mbrojtjeje për konsumatorët”.

KEK-u e bën më të lehtë njohjen e kualifikimeve

KEK-u lehtëson njohjen e kualifikimeve duke promovuar përdorimin e rezultateve të të mësuarit, duke u lejuar mbajtësve dhe marrësve të kualifikimeve të vlerësojnë direkt përmbajtjen, nivelin dhe profilin e kualifikimeve në fjalë.

KEK-u funksionon së bashku me instrumentet e tjera evropiane dhe ndërkombëtare që mbështesin njohjen e kualifikimeve. Ndërkohë që këto instrumente fokusohen te kualifikimet e rregulluara dhe/ose akademike, KEK-u mbështet njohjen e të mësuarit për të gjitha kualifikimet.

Instrumentet evropiane dhe ndërkombëtare që mbështesin njohjen e kualifikimeve

- Direktiva 2005/36/EC i adresohet njohjes së kualifikimeve profesionale në BE, duke u dhënë mundësinë profesionistëve të lëvizin përmes kufijve dhe të praktikojnë profesionin e tyre ose të ofrojnë shërbime jashtë vendit⁷;
- Konventa e njohjeve e Lisbonës⁸ është një marrëveshje ndërkombëtare që administrohet nga UNESCO dhe Këshilli i Evropës, që lejon njohjen e kualifikimeve akademike në Evropë dhe më tej;
- Rrjeti ENIC/NARIC network⁹ është një rrjet me qendra kombëtare i ngritur për të mbështetur direkt institucionet dhe qytetarët me njohjen e kualifikimeve akademike.

7 2018-80078-0-1, me afat përfundimtar 6.12.2018

8 <https://rm.coe.int/168007f2c7>

9 <http://www.enic-naric.net/>

KEK-u mbështet mjetet e tjera të transparencës së BE-së

Komisioni Evropian, në bashkëpunim të ngushtë me Shtetet Anëtare, ka prezantuar një numër mjetesh që mbështesin modernizimin e sistemeve evropiane të arsimit dhe formimit gjatë dekadës së fundit. Duke u fokusuar në nevojën për më shumë transparencë dhe krahasueshmëri të aftësive dhe kualifikimeve, këto mjete mbështetin të mësuarit gjeografik dhe gjatë gjithë jetës të qytetarëve. Perspektiva e rezultateve të të mësuarit mund të shihet si një “zamkë” që i ngjit këto mjete së bashku, duke respektuar diversitetin e zgjidhjeve kombëtare, por njëkohësisht duke lejuar që ato të punojnë së bashku.

Shumë nga këto mjete u adresohen direkt qytetarëve, si në rastin e Europass dhe sistemeve të kreditit për arsimin e lartë (ECTS) dhe AFP (ECVET). Ndërkohë që Europass mbështet individët në të mësuarit dhe karrierën e tyre, sistemet e kreditit lehtësojnë rrugët fleksibël të të mësuarit dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Një grup tjetër mjetesh mbështet punën e autoriteteve dhe institucioneve kombëtare, dhe u adresohet në mënyrë të tërthortë nevojave të qytetarëve individualë. Kjo aplikohet për një gamë nismash udhëzuese për karrierën dhe verifikimin e të mësuarit, ku nismat evropiane janë një nxitje për krijimin e marrëveshjeve dhe praktikave të ndarjes kombëtare. Mjetet që mbështesin bashkëpunimin rreth sigurisë së cilësisë në arsimin e lartë (ESG) dhe AFP (EQAVET) synojnë të rrisin besimin dhe transparencën mes vendeve. Gjithashtu, me prezantimin e klasifikimit ESCO, Komisioni ka vënë në zbatim një terminologji që mbështet fokusimin te rezultatet e të mësuarit dhe forcimin e dialogut mes grupeve të interesit në arsim dhe formim dhe tregut të punës.

**Çfarë ndikimi ka deri më
tani KEK-u?**

Pamje e përgjithshme

Që prej vitit 2008, 39 vende janë angazhuar me KEK-un. Përveç 28 Shteteve Anëtare të BE-së, kjo shifër përfshin 11 shtete jo anëtare (Shqipëria, Bosnjë e Hercegovina, Maqedonia Veriore, Islanda, Kosova¹⁰, Lihtenshtejni, Mali i Zi, Norvegjia, Serbia, Zvicra dhe Turqia).

Aktualisht, 35 vende (27 Shtete Anëtare të BE-së dhe 8 shtete joanëtare) i kanë referuar KKK-të ose sistemet e tyre të KEK-u. Kjo do të thotë se është krijuar një lidhje e qartë mes niveleve kombëtare dhe evropiane. Shumica e raporteve të referencimit janë publikuar gjithashtu në portalin PLOTEUS¹¹.

Për të arritur implementimin e plotë dhe për të rritur ndërgjegjësimin mes publikut të gjerë, vendet duhet të marrin masa në mënyrë që kualifikimet e tyre të përmbajnë një referencë të qartë të niveli përkatës i KEK-ut. Nivelet evropiane duhet të shfaqen në dokumentet e kualifikimeve dhe në databazat ose regjistrat e kualifikimeve për t'i bërë kualifikimet më transparente dhe më të krahasueshme. Vizibiliteti i niveleve të KEK-ut është një element kyç i suksesit të implementimit të KEK-ut.

Aktualisht, 23 vende të referuara në KEK i shfaqin nivelet e KEK-ut në certifikata, diploma ose në suplementet e Europass, ndërsa 17 vende i shfaqin nivelet e KEK-ut në databazat ose regjistrat e kualifikimeve. Një numër vendesh tani punojnë për të lidhur databazat e tyre me portalin PLOTEUS. Ato mund t'i lidhin gjithashtu kualifikimet e tyre me portalin ESCO¹².

Zhvillimi i KKK-ve dhe zhvendosja të rezultatet e të mësuarit

KEK-u ka pasur një ndikim të madh në zhvillimin e KKK-ve në Evropë. Aktualisht, janë krijuar 43 KKK, ndërsa vetëm 3 ekzistonin përpara miratimit të Rekomandimit të parë të KEK-ut në vitin 2008.

Shumica e vendeve kanë prezantuar korniza me tetë nivele, megjithëse disa kanë më pak ose më shumë (p.sh. korniza franceze ka 5 nivele, irlandezja 10 dhe skocezja 12). Një numër vendesh përdorin gjithashtu nën-nivele, që shihen si të rëndësishme për të plotësuar interesat e grupeve të caktuara të interesit dhe ndonjëherë për të lejuar përfshirjen e vlerësimeve të mëparshme.

Ndërkohë që fazat e hershme të KEK-ut fokusoheshin kryesisht në krijimin e KKK-ve për t'i referuar këto të KEK-u, aktivitetet aktuale të shumë KKK-ve përqendrohen në caktimin e niveleve të kualifikimit individuale dhe në rishikimin e kualifikimeve. Përmes zhvillimit të kornizave kombëtare, KEK-u ka kontribuar në përmirësimin e transparencës së sistemeve kombëtare të kualifikimeve.

10 Ky përcaktim bëhet pa paragjykuar pozicionin për statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe Opininion e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi deklarimin e pavarësisë nga Kosova

11 <https://ec.europa.eu/esco/portal/home>

12 <http://ec.europa.eu/esco>

Dialogu mes grupeve të interesit

Një ndikim tjetër ka qenë përfshirja dhe dialogu mes grupeve të interesit të arsimit/formimit dhe të punësimit, si dhe faktorëve të ndryshëm brenda fushës së arsimit/formimit. Të frymëzuara nga KEK-u, pothuajse të gjitha KKK-të janë komiza gjithëpërfshirëse që përfshijnë një spektër të gjerë kualifikimesh. Si rezultat, janë ngritur struktura të përhershme dialogu në vende të ndryshme që përfshijnë autoritete publike, partnerë socialë, të arsimit të lartë dhe AFP, si dhe organizata civile.

KKK-të dhe AFP i lartë

Implementimi i KEK-ut dhe ky dialog kanë rezultuar në një nivel më të lartë barazie mes AFP dhe arsimit të lartë në disa vende. Elementet përshkruese të KEK-ut janë neutrale në lidhje me formimin akademik dhe profesional, dhe nuk përshkruajnë se në çfarë niveli duhet të vendosen llojet e ndryshme të kualifikimeve. Implementimi i KEK-ut tregon se kualifikimet me orientim profesionist dhe profesional mund t'u referohen gjithashtu niveleve 5-8 (për shembull, kualifikimi gjerman dhe austriak për kryemjeshtrë i referohet nivelit 6, ndërsa KKK-ja zvicerane është projektuar në mënyrë të qartë që ta mbështesë këtë parim).

Lidhja e kornizave të kualifikimeve dhe verifikimi i të mësuarit jozyrtar dhe informal

Rekomandimi i vitit 2012 mbi verifikimin e të mësuarit jozyrtar dhe informal e konsideroi lidhjen me KKK-të si të rëndësishme për implementimin e mëtejshëm të marrëveshjeve të verifikimit nëpër Evropë. Përditësimi i vitit 2016 i inventarit evropian për vërtetimin¹³ konfirmoi se vendet tani i japin prioritet të lartë lidhjes së kornizave dhe marrëveshjeve të ratifikimit. KEK-u dhe KKK-të, përmes fokusimit të tyre te rezultatet e të mësuarit, veprojnë si pikë reference për identifikimin, dokumentimin, vlerësimin dhe njohjen e të mësuarit të fituar në mjedise jozyrtare dhe informale.

Kualifikimet e fituara jashtë arsimit dhe formimit zyrtar

Shumica e KKK-ve mbulojnë kualifikimet e marra brenda arsimit dhe formimit zyrtar (p.sh. AFP, arsimi i lartë dhe arsimi i përgjithshëm). Këto kualifikime rregullohen dhe jepen nga autoritetet kombëtare. Megjithatë, ekziston tendenca në rritje mes vendeve për të zgjeruar kornizat e tyre për të përfshirë kualifikimet që jepen në arsimin dhe formimin e mëtejshëm, që zakonisht jepen jashtë sistemit kombëtar zyrtar të kualifikimeve.

Ndikimi në botë

KEK-u dhe elementet e tij përshkruese të niveleve, kanë qenë burim frymëzimi për zhvillimin e kornizave të kualifikimeve në mbarë botën. Aktualisht ekzistojnë ose janë në zhvillim e sipër më shumë se 150 KKK¹⁴. Një efekt anësor pozitiv i njohjes së konsiderueshme të KEK-ut jashtë Evropës ka qenë se organet e njohjes së kualifikimeve i kuptojnë më lehtë kualifikimet, gjë që lehtëson njohjen e tyre.

13 <http://www.cedefop.europa.eu/en/events-and-projects/projects/validation-non-formal-and-informal-learning/european-inventory>

14 <https://publications.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/406d3baf-deef-11e7-9749-01aa75ed71a1/language-en>



Një vështrim në të ardhmen

Rishikimi i Rekomandimit të KEK-ut në maj 2017, i dha procesit të KEK-ut një shtysë të re. Rekomandimi i fton Shtetet Anëtare të rishikojnë dhe përditësojnë referimin e tyre të KEK-u kur është e përshtatshme, gjë që ndihmon që të sigurohet që informacioni që përforcon referimin është i saktë, transparent dhe reflekton çdo ndryshim të konsiderueshëm në nivel kombëtar. Në të njëjtën kohë, mbetet e pandryshuar baza e procesit të KEK-ut, konkretisht KKK-të referuese dhe nivelet e tyre në KEK.

Rekomandimi i rishikuar shënon një hap të rëndësishëm në maturimin e KEK-ut. Ndërkohë që fazat e hershme të KEK-ut fokusoheshin kryesisht në referimin e KKK-ve të korniza e përbashkët e referencës, procesi tani karakterizohet nga përfshirja e kualifikimeve në korniza. Të gjitha kualifikimet e kornizave të referuara në KEK, duhet të respektojnë parimet e përbashkëta të sigurisë së cilësisë të Aneksit IV të Rekomandimit.

Në kontekstin e KEK-ut, hartimi i procedurave për t'u dhënë nivele kualifikimeve ndërkombëtare të përfshira në kornizat kombëtare do të jetë një fushë e re pune në të cilën do të jetë e rëndësishme konsistenca e shkëmbimit të informacionit dhe konsultimi mes Shteteve Anëtare.

Rekomandimi i rishikuar gjithashtu hap bashkëpunime të mundshme me vendet e treta për të mundësuar krahasimin e kornizave të tyre (kombëtare ose rajonale) të kualifikimeve me KEK-un. Ky bashkëpunim do të forconte krahasueshmërinë e kualifikimeve evropiane dhe të vendeve të treta, si dhe do të lehtësonte lëvizshmërinë si të qytetarëve të BE-së ashtu edhe atyre jo të BE-së.

Në të ardhmen e afërt, do të bëhet punë e mëtejshme rreth përshkrimit, përdorimit dhe aplikimit të rezultateve të të mësuarit për të rritur transparencën, të kuptuarin dhe krahasueshmërinë e kualifikimeve.

Komunikimi do të përmirësohet për të krijuar më mirë kontakte me punëdhënësit, ofruesit e arsimit dhe formimit, studentët, punëtorët dhe grupet e tjera të interesit dhe për t'i informuar ata rreth përfitimeve të KEK-ut dhe KKK-ve. Për të treguar vlerën e shtuar të KEK-ut dhe për të stimuluar përdorimin e tij, Rekomandimi i rishikuar vazhdon të theksojë rëndësinë e afishimit të niveleve përkatëse të KEK-ut për kualifikimet.

Si përfundim, KEK-u ka gjithashtu mjetet e duhura për të trajtuar zhvillimet e ardhshme në të mësuar dhe punë. Për t'u përshtatur botës së sotme dixhitale, nivelet e KEK-ut mund të afishohen gjithashtu edhe në databazat e kualifikimeve. Gjithashtu, në Rekomandimin e rishikuar është përfshirë një set i përbashkët me fusha të dhënash për publikimin elektronik të informacionit rreth kualifikimeve me një nivel KEK-u. Kjo do t'i ndihmojë të gjithë që të qëndrojnë në një hap me mënyrat e reja për ndarjen dhe lidhjen e informacionit në dobi të studentëve, punëkërkuessve dhe punëdhënësve. Do të vazhdojë gjithashtu puna në portalet evropiane për të garantuar që informacioni mbi kualifikimet të jetë i aksesueshëm dhe i publikuar, duke iu përshtatur nevojave të realitetit të së nesërme.

Akronimet

Qendra Evropiane për Zhvillimin e Formimit Profesional	Cedefop
Sistemi Evropian i Krediteve për Arsimin dhe Formimin Profesional	SEKAFP
Sistemi Evropian i Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve	SETGK
Korniza Evropiane e Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës	KEK
Siguria Evropiane e Cilësisë në Arsimin dhe Formimin Profesional	SECAFP
Aftësitë, Kompetencat, Kualifikimet dhe Profesionet Evropiane	ESCO
Standardet dhe Direktivat Evropiane për sigurinë e cilësisë në fushën e arsimit të lartë në Evropë	SDE
Fondacioni Evropian i Formimit Profesional	ETF
Bashkimi Evropian	BE
Korniza(t) Kombëtare të Kualifikimeve	KKK-të
Arsimi dhe Formimi Profesional	AFP

Si të kontaktoni personalisht me BE-në

Në mbarë Bashkimin Evropian ka qindra Qendra për Informim të Europe Direct.
Adresën e qendrës më pranë jush mund ta gjeni në: <http://europa.eu/contact>

Me telefon ose email

Europe Direct është një shërbim që u përgjigjet pyetjeve tuaja rreth Bashkimit Evropian.

Këtë shërbim mund ta kontaktoni:

- me telefon falas: 00 800 6 7 8 9 10 11 (disa operatorë mund të tarifojnë për këto telefonata),
- në numrin standard të mëposhtëm: +32 22999696 ose
- me email përmes: https://europa.eu/european-union/contact_en

Gjetja e informacioneve në internet rreth BE-së

Informacioni rreth Bashkimit Evropian në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së është i disponueshëm në uebsajtin "Europa" në: https://europa.eu/european-union/index_en

Publikimet e BE-së

Ju mund të shkarkoni ose porosisni publikime falas dhe me pagesë të BE-së në: <https://publications.europa.eu/en/publications>. Më shumë se një kopje e publikimeve falas mund të merren duke kontaktuar Europe Direct ose qendrën tuaj lokale të informacionit (shikoni https://europa.eu/european-union/contact_en).

Ligji i BE-së dhe dokumentet përkatëse

Për të aksesuar informacionet ligjore rreth BE-së, duke përfshirë të gjitha ligjet e BE-së që prej vitit 1952 në versionet në të gjitha gjuhët zyrtare, shkoni te EUR-Lex në: <http://eur-lex.europa.eu>

Të dhënat e hapura nga BE-ja

Portali i EU Open Data Portal (<http://data.europa.eu/euodp/en>) ofron akses në setet e të dhënave nga BE-ja. Të dhënat mund të shkarkohen dhe ripërdoren falas, si për qëllime komerciale ashtu dhe jokomerciale.

Komiza Evropiane e Kualifikimeve për të mësuarit gjatë të gjithë jetës (KEK) synon të përmirësojë transparencën, krahasueshmërinë dhe portabilitetin e kualifikimeve të individëve. Kjo broshurë është publikuar për të shënuar 10 vjetorin e KEK-ut dhe ofron një përmbledhje të kuadrit në përgjithësi, si mund të përdoret ai dhe kush përfiton prej tij. Në të gjithashtu theksohen arritjet e KEK-ut gjatë 10 viteve të fundit dhe hidhet një vështrim drejt së ardhmes.

Ju mund të shkarkoni publikimet ose të abonoheni falas në ec.europa.eu/social/publications

Nëse dëshironi të merrni rregullisht përditësime rreth Drejtorisë së Përgjithshme për Punësimin, Çështjet Sociale dhe Përfshirjen, regjistrohuni për të marrë buletin informativ falas të "social europe" në ec.europa.eu/social/e-newsletter



@socialeurope



@EU_Social

